

UDHËZIM
Nr. 4360, datë 28.4.2017

PËR ORGANIZIMIN E VIZITAVE TURISTIKE NË ISHULLIN E SAZANIT

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe Marrëveshjes së Bashkëpunimit nr. 2751, datë 5.4.2017 Për lejimin e turistëve për vizita turistike në ishullin e Sazanit,

UDHËZOJ:

1. Ky udhëzim ka për qëllim përcaktimin e rregullave që duhet të ndiqen për mbarrëvajtjen e vizitave turistike në ishullin e Sazanit, të cilat mund të zhvillohen gjatë periudhës së lejuar nga data 01.05.2017 deri më 31.10.2017, nga ora 08:00 deri në 19:00.

2. Ky udhëzim do të zbatohet për të gjithë vizitorët, operatorët turistikë dhe subjektet e transportit turistik detar të udhëtarëve, që marrin pjesë në organizimin e vizitave turistike në ishullin e Sazanit.

3. Personat fizikë dhe juridikë mund ta aksesojnë ishullin e Sazanit vetëm në portin ushtarak të tij dhe vetëm në periudhën dhe orarin e përcaktuar në pikën 1 të këtij udhëzimi.

4. Të gjithë vizitorët mund të vizitojnë ishullin e Sazanit, pasi të jenë pajisur me biletë hyrje, pranë sportelit të Bashkisë së Vlorës të vendosur në portin ushtarak të ishullit. Nëpërmjet kësaj bilete ata kanë të drejtën të kryejnë vizitën të organizuar në grupe dhe të shoqëruar nga një person i autorizuar nga Bashkia e Vlorës.

5. Gjatë vizitave turistike në brendësi të ishullit, vizitorët duhet të respektojnë itineraret dhe hapësirat e lejuara të indicuara me sinjalistikë dhe tabelat orientuese të vendosura nga Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura për sigurinë e tyre fizike.

6. Të gjithë operatorët turistikë të cilët organizojnë ture ditore në ishullin e Sazanit duhet të vënë në dispozicion një person të ngarkuar për shoqërimin e tyre në lidhje me ndalesat e përgjithshme në Ishullin e Sazanit, itinerarin e lëvizjes, si dhe sigurinë e tyre fizike.

7. Mjetet lundruese turistike detyrohen të pajisen me lejen përkatëse nga Kapiteneria e Portit të Vlorës për udhëtimin në drejtim të ishullit të Sazanit, në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon transportin e udhëtarëve dhe të mjeteve lundruese turistike në ujërat e brendshme detare.

8. Në Ishullin e Sazanit ndalohen:

- a) Ndërtimet e reja, si edhe punimet publike ose private;
 - b) Qarkullimi dhe qëndrimi i mjeteve motorike jashtë vendeve të parashikuara për këtë qëllim, me përjashtim të mjeteve të shërbimit dhe të sigurisë;
 - c) Veprimtaritë tregtare që me përjashtim të atyre që sigurojnë mbrojtjen dhe promovimin e Ishullit të Sazanit;
 - d) Aktivitetet e zhytjeve, me përjashtim të zonave të lejuara për këtë qëllim.
- Shkeljet e ndalimeve sipas kësaj pike dënohen sipas legjislacionit në fuqi.
9. Operatorët turistikë që organizojnë ture ditore në ishullin e Sazanit, në paketën e tyre turistike, duhet të informojnë turistët me shkrim, lidhur me mungesën e ofrimit të shërbimeve të ushqimit dhe të pijes.
- Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ZHVILLIMIT EKONOMIK, TURIZMIT,
TREGTISË DHE SIPËRMARRJET
Milva Ekonomi